



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Mbi Auditimin Financiar të ushtruar në

Bashkinë Tepelenë

Tiranë, shtator 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	3
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-7
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	6-7
II	HYRJA	7-12
1	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	8
2	Identifikimi i çështjes	8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	9-10
6	Standardet e auditimit	10
7	Metoda e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-55
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Tepelenë	12
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12-55
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm	12-24
2.2	Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore	24-45
2.3	Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	45-55
IV	REKOMANDIME	55-61

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit në Bashkinë Tepelenë.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 470/1 prot., datë 25.04.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi **Bashkinë Tepelenë**, për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024. Për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve është në vlerën 657,619 mijë lekë ndërsa të ardhurat e veta janë në vlerën 74,990 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Tepelenë për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- ✓ *Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm;*
- ✓ *Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;*
- ✓ *Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare. Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë

të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 13,152 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik; Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 13 gjetje dhe ka dhënë 13 rekomandime të cilat i përkasin kategorisë Masa Organizative.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 49 “Shuma të parashikuar për zhvlerësim” është kontabilizuar vlera - 41,090,540 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të cilët nga Bashkia Tepelenë janë cilësuar si pa mundësi arkëtimi, ndërkohë që sipas trajtimit kontabël kjo vlerë duhej të kontabilizohet në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Sipas informacionit kontabël llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar në vlerën 41,090,540 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 12,549,167 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 928,469 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 3,610,071 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 498,845 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 52,599,510 lekë ku totali shkon në vlerën 70,186,062 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 33,157,848 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” është nënvlerësuar në vlerën 37,028,214 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 1,500,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 206,139,272 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 207,639,272 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

- Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,541,435,584 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 229,974,201 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 5,118,572 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 59,226,065 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 28,480,169 lekë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemin e vlerës 41,090,540 lekë nga llogaria 49 “Shuma të parashikuar për zhvlerësim” e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të klasifikimit të kësaj vlere debitore nga taksat dhe tarifatat vendore për zhvlerësim, duke e kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

- Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Tepelenë, KLSH ka dhënë **“Opinionin i modifikuar/kualifikuar me rezervë”** për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Tepelenë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Tepelenë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të “modifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar,

të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 13,152 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Në gjendjen e llogarisë 49 “Shuma të parashikuar për zhvlerësim” është kontabilizuar vlera - 41,090,540 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të cilët nga Bashkia Tepelenë janë cilësuar si pa mundësi arkëtimi, ndërkohë që sipas trajtimit kontabël kjo vlerë duhej të kontabilizohej në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Sipas informacionit kontabël llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar në vlerën 41,090,540 lekë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 12,549,167 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 928,469 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 3,610,071 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 498,845 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 52,599,510 lekë ku totali shkon në vlerën 70,186,062 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 33,157,848 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” është nënvlerësuar në vlerën 37,028,214 lekë.

- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” është mbivlerësuar në vlerën 457,000 lekë.

- Gjendja e llogarisë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,500,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,500,000 lekë.

Kjo llogari përbëhet nga një projekt me emërtimin “Hartim plane mbarshtimi pyje kullota” në vlerën 1,500,000 lekë i përfunduar dhe i likuduar dhe për pasojë duhej të kontabilizohej në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 1,500,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 206,139,272 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 207,639,272 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

- Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,541,435,584 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 229,974,201 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 5,118,572 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 59,226,065 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 28,480,169 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 470/1 prot., datë 25.04.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 28.04.2025, deri më 09.06.2025, në institucionin

Bashkia Tepelenë u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E.K. (Përgjegjës grupi)
2. M.H., anëtar
3. A.S., anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bzaë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Tepelenë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Tepelenë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i

ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tjera.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Tepelenë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Tepelenë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;

- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave lokale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë” i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metoda e auditimit: Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve);

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

6. Kontrolli sipas një treguesi:

¹ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- Verifikimi i transaksioneve është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimin e mbajtur, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Tepelenë”:

Tepelena kufizohet në veri me Bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Gjirokastër dhe në perëndim me Bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 24 fshatra. Bashkia e Tepelenës zgjerohet me disa zona rurale, të cilat merren kryesisht me blegtori. Shërbimet e vogla tregtare dhe mbledhja e bimëve medicinale sigurojnë pak të ardhura për familjet. Një nga projektet më të rëndësishme është ai i qendrës së qytetit të Tepelenës, ku synohet edhe rivitalizimi i Kalasë së Ali Pashës në funksion të nxitjes së turizmit. Kjo kala, por edhe pasuri të tjera si kanioni i Bënçës, ura e Beçishtit apo Uji i Ftohtë mund të shërbejnë për nxitjen e turizmit kulturor dhe natyror. Ekonomia e Bashkisë Tepelenë karakterizohet nga prezenca e informalitetit dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar riskun e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, efiçente

dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”:

- Bashkia Tepelenë ka të miratuar Kodin e Etikës me Vendimin nr. 4, datë 13.01.2023, ku janë përcaktuar veprimet që parandalohen në Kapitulli II “Etika dhe sjellja etike”, Kapitulli III “Etika e paraqitjes” dhe të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes. Ndërsa në Kapitullin “Sanksionet” për procedurat disiplinore për shkeljen e rregullave të etikës së shërbimit civil, mos plotësim të detyrave, thyerjes së disiplinës si dhe rastet e tjera të parashikuar nga Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojnë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

Në lidhje me njohjen e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi, kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë hartuar rregullore përkatësisht Rregullore nr. 156, datë 27.11.2017, “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Tepelenë” dhe Rregullore nr. 82/1, datë 24.12.2019, “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë Tepelenë”.

Gjithashtu procedura për sinjalizimin është përcaktuar dhe në Rregulloren e Brendshme, neni 25, në të cilat janë përcaktuar veprimet që parandalohen, ndëshkimin e rasteve, procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës.

Për shkeljet e administrative në lidhje me Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit publik”, në nenin 20 të Rregullores së Brendshme, janë parashikuar përgjegjësia administrative dhe detyrat e koordinatorit të së drejtës për informim. Për çdo vit është hartuar raporti i njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, me shkresat përkatëse, depozituar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI). Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e protokollit), zyrës me një ndalesë dhe koordinatorit të informimit publik, duke i'u adresuar Kryetarit të Bashkisë, këto struktura janë të përcaktuara, në nenin 20 (koordinatori publik), neni 35/26 (zyra me një ndalesë) dhe neni 35/22 zyra e protokollit të Rregullores së Brendshme.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në vit.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”:

- Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga drejtoritë dhe sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NjA drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë

sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore, por raportimi është realizuar për periudha 3-mujore e 6-mujore. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafine lartë menaxherial. Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga Shoqëria Rajonale e UK sha Gjirokastrë, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen këshillit drejtues, pasi bashkia është një nga aksionerët, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt mbledhjes së të ardhurave.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Audit i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

- Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”:

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kane marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave të rumbullakëta me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjesat me publikun.

- Rregullorja e Brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri njëfarë mase, mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, si dhe janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

Në Bashkinë Tepelenë, funksionin shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht funksionojnë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas rregullores së brendshme. Mënyra e shkëmbimit të informacionit dokumentar dhe elektronik është përcaktuar në pjesë të veçanta të Rregullorës së Brendshme të Bashkisë Tepelenë, nenet 21-22, nenet 28-29, dhe kreu VI “Administrata e Bashkisë”. Kanë funksionuar linjat e komunikimit të jashtëm në lidhje me dhënie dhe marrjen e informacionit për njësitë vartëse jashtë Bashkisë Tepelenë por edhe të tretë jashtë sistemit. Është funksionale faqja ëeb-Bashkia Tepelenë, në të cilën ka informacione relativisht mjaftueshëm për aktivitetin, veprimtarinë, raporte monitorimi mbi realizimin e planeve vjetore, etje., por është evidentuar mangësia si më poshtë:

Sa i përket komunikimit të brendshëm, nuk janë identifikuar, hartuar dhe miratuar llojet e raportimit brenda strukturave të bashkisë, më funksion të monitorimit të realizimit të objektivave strategjike dhe vjetorë të përcaktuara në planet përkatëse.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”:

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Tepelenë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave (mungojnë të dhënat për trajnime jashtë institucionit).

- Për bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për çdo vit. NA për çdo vit ka nxjerrë Urdhrat e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

- Nuk ka urdhrë për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se: “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm”.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”:
Në Rregulloren e Brendshme në pikën (27.1) të nenit 27 është parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin e institucionit rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Udhëzimit të MFE nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS.

Është miratur Udhëzuesi i Brendshëm nr. 56/1 prot, datë 10.01.2023, “Për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tepelenë”.

Në rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, duke përfshirë dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), për të cilin nuk përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitëe tij.

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk e kryer detyrat si:

- Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:

Në lidhje me parimin 6 “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva”:

Bashkia Tepelenë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operationale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësive të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Tepelenë. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në Këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësive, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7 “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”:

Në Bashkinë Tepelenë ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut por është parashikuar në Rregulloren e Brendshme neni 11, si dhe mungon urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Është hartuar rregjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, por jo për të gjitha drejtoritë janë evidentuar risqet dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë. Duke mos u përcaktuar koordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8 “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”:

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskt për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut por jo të grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9 “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”:

Bashkia Tepelenë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 10 “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”:

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA). Struktura e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar përbëhet nga 8 punonjës, 1 drejtor, 2 përgjegjës Sektori.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe në nenin 32 të Rregullores së Brendshme.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Në Rregulloren e Brendshme neni 35.23 “Specialisti i Arshivës,” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshmenë detyrat e drejtorisë Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nenet 36 (36.1-36.16), por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pikësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11 “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”:

- Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të

ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT. Faqja Zyrtare e Bashkisë Tepelenë në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

Në lidhje me parimin 12 “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”:

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

- Në nenet nenet 36 (36.1-36.16) të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

- Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi merren Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Planifikimit Zhvillimit Kontrollit të Territorit; Drejtoria e Shërbimeve Publike; Drejtoria e Zhvillimit Rural. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive neni 36 -38 dhe 41 të rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilzimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.08.2018, “Për hartimin e PF”). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”:

Në lidhje me parimin 13 “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”:

Drejtesit në Bashkinë Tepelenë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit. Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Drejtoria Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel dhe program të veçantë që i menaxhon Sektori i Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Tepelenë për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Mbahen akt-rakordimet me Agjentët Tatimorë si Shoqëria Rajonale UK, DRT, ASHK, DRTRr etj. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumenta financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14 “Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor”:

Në lidhje me parimin 15 “Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”. Ka faqen e saj zyrtare. Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet neni 13 “Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak”; neni 19 “Informimi dhe komunikimi me median”, neni 20 “Informimi dhe marrëdhëniet me publikun”, neni 9 “Marrëdhëniet me institucionet e tjera”; neni 12 “Marrëdhëniet nëpërmjet sturkturave të bashkisë”, neni 29 “Korrespondenca”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo 4 muaj dhe nëpërmjet analizave të herë pas hershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Në përdorimin e emailit zyrtar kanë akses të gjithë punonjësit, por komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Tepelenë janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e Këshillit Bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

- Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Nga Bashkia Tepelenë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

V. Komponenti “Monitorimi”:

Në lidhje me parimin 16 “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”:

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarami se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.

2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësisive vartëse.

3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.

4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Në Bashkinë Tepelenë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshëm dhe efektiviteti i shërbimeve publike e

shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm vetëm në auditimet në institucionet e varësisë dhe jo për Drejtoritë e Aparatit të Bashkisë, duke u shprehur në të njëjtin format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara

Në lidhje me parimin 17 “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”:

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për MFK-në u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

1. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezultoi se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet, por mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës të specialistit të IT.

2. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:

Është përcaktuar koordinatori i riskut me rregullore, por nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve e për pasojë dhe mungesës së veprimtarisë së tij, ka sjellë mos identifikimin e vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

3. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”:

- Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka nmungesa në burime njerëzore. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk fushë drejtimi auditimi nga AB.

4. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”:

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

5. Komponenti “Monitorimi”:

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjës: z. T.P. Kryetar i Bashkisë Tepelenë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. S.K. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Organika e miratuar për Bashkinë Tepelenë, paraqitet si vijon:

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish (fakt) 2024
1	Përgjegjës Sektori	1	1
2	Specialist	1	1
Totali		2	2

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

Struktura e Njësies së Auditimit të Brendshëm është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë më datë 05.02.2020, me përbërje sipas strukturës 1 Përgjegjës i NjAB. Për vitin 2022 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 Përgjegjës. NjAB në Bashkinë e Tepelenës është e organizuar si Njësi në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë. Struktura e personelit të Njësies është:

- Ekonomist 1 Përgjegjës Sektori, Punonjësit e sektorit të AB janë të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, në bazë të Ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, certifikimi për punonjësin ka pëfunduar në Shtator 2021.

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, Sektorin e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 punonjës.

- Me shkresën nr. 215/1 prot., datë 15.06.2021, është rishikuar dhe hartuar nga Sektorin e Auditimit të Brendshëm dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë “Karta e Auditimit të Brendshëm”, kjo bazuar në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” në nenin 4 pika “12”, në nenin 12 pika “c”, me përcaktimin e statusit organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmëritë dhe përgjegjësitë e auditit të brendshëm.

- Gjatë periudhës së auditimit, në Bashkinë Tepelenë struktura e sektorit të Auditit, nuk ka qenë e plotësuar.

- Njësia e AB në Bashkinë Tepelenë mbulon me auditim:

1. Njësia Administrative Qytet Tepelenë.
2. Njësia Administrative Qendër Tepelenë.
3. Njësia Administrative Kurvelesh.
4. Njësia Administrative Lopes, si edhe sektorët e mëposhtëm:
Drejtoria e Financës, Sektori i Tatim Taksave (2 fusha), Drejtori e financës (Auditime të prapambetura).

➤ **Komiteti i Auditit të Brendshëm:**

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se :“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
 - b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
 - c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
 - ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
 - d) duke monitoruar zbatimin e rekoman-dimeve të dhëna;
 - dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm është bërë në zbatim të programit “Vjetor dhe Planit Strategjik,” për periudhën 01.01.2025, deri më 31.12.2027, të Bashkisë Tepelenë, i cili u miratua me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 158, datë 21.10.2024, dhe është dërguar me shkresë përcjellse Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, (Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm) Tiranë me nr. 1761/3 prot., datë 21.10.2024.

Në lidhje me këtë angazhim të auditimi, është miratuar programi i punës nga ana e Kryetarit të Bashkisë me nr. 1846 prot., datë 09.10.2024, për auditimin e të gjithë sektorëve të tatim taksave të Bashkisë, duke përfshirë edhe të gjitha zyrat e tatim taksave të NjA të Bashkisë Tepelenë për periudhën 01.01.2024, deri më 31.10.2024, mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave vendore, si dhe Detyrimeve të Prapambetura për 10 mujorin e vitit 2024, “Mbi auditimin me bazë sistemi (përputhshmerie ligjore) të ushtruar në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar, mbi të ardhurat nga Taksat dhe Tarifat Vendore, në Sektorin e Tatim Taksave dhe Njësi Administrative vartëse”.

Ligjshmëria dhe rregullshmëria e zhvillimit të veprimtarisë, përdorimit të burimeve financiare, dokumentimi, administrimi dhe qarkullimi i vlerave monetare e materiale.

“Mbi auditimin me bazë financiare, për Detyrimet e Prapambetura, për 10 Mujorin e vitit 2024 (Analiza e tyre, sipas Pasqyrave Financiare).

Në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 100/2016, “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, Manuali i Auditimit të Brendshëm i ndryshuar, Kapitulli i IV-t “Kryerja e Auditimit të Brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit,” pika 4.1.12, hapi 11.

- Kryerja e angazhimeve në Planin Vjetor, të Auditimit të Brendshëm, janë planifikuar 8 auditime gjithsej me gjithë auditimin e Detyrimeve të Prapambetura). Kjo brenda Drejtorisë së Zhvillimit

Ekonomik & Menaxhimit Financiar dhe në 4 NjA të Bashkisë Tepelenë, pra janë planifikuar në institucione të Varësisë, konkretisht në 4 Njësitë Administrative të Bashkisë. Në NjA janë audituar 4 misione të Përputhshmërisë Ligjore dhe 3 misione auditime financiare.

Ndërsa në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar është planifikuar 1 auditim Financiar mbi Detyrimet e Prapambetura për 10 mujorin e vitit 2024. Njëkohësisht në këtë mision është kryer edhe një auditim financiar mbi auditimin e vlerave monetare në arkën që disponon kjo Bashki.

Pra, duhet të theksojme se, janë planifikuar auditime të Përputhshmerie Ligjore 4 Auditime dhe auditime të Performancës Financiare 4 auditime. Janë realizuar nga ana e auditit të brendshëm në masën 100 %. Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrolleve dhe sistemit të Detyrimeve Financiare të Prapambetura në përputhje me ligjet dhe rregullat, identifikimi i mangësive dhe ndërmarja e veprimeve korrigjuese.

Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre, Planet Strategjike dhe Vjetore të Auditimit të Brendshëm janë përgatitur mbi bazën e riskut duke identifikuar dhe vlerësuar, risqet kryesore për veprimtarinë e institucionit të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë.

Vlerësimi i riskut është bërë sipas problematikave të paraqitura nga titullari i institucionit në takimet e zhvilluara, analiza e raporteve vjetore, raportet e auditimeve të mëparshme dhe në Raportin e Auditit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbështetur mbi strategjinë e riskut të hartuar nga institucioni, duke shërbyer si bazë, për vlerësimin e tij.

Nga analiza e raporteve vjetore individuale si dhe nga intervistat e realizuara, rezulton se përcaktimi i nivelit të riskut, është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut, të cilët në mënyrë të përmbledhur do të përgjithësoheshin në kategoritë e mëposhtme:

Sasia dhe përdorimi i burimeve në punë të institucionit të audituar;

Struktra e NjAB e paplotësuar.

Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2024 janë audituar 4 dosje të realizuara në subjektet e lartëpërmenduar, ku rezulton se nga NjAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë përgjithësisht korrekte, por ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

- Në përgjithësi nga NjAB është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm.

- Nga auditimi u konstatua se janë respektuar afatet e auditimit, ku me saktësisht, raporti përfundimtar i auditimit referuar manualit për manxhimin financiar duhet të dërgohet subjektit 7 ditë pune pas reagimit të subjektit, afat i cili është respektuar.

- Nga auditimi u konstatua se në dosje ka plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit për 6 mujorin paraardhës e cila plotësohet nga njësia publike e audituar si dhe e miratuar nga titullari jo më vonë se 20 ditë pune pasi subjekti njihet me raportin përfundimtar, i dërguar njësisë, në përputhje kjo me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016, të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për vitin 2023, në Bashkinë Tepelenë, është kryer Zbatimi i Rekomandimeve (detyrat e lëna), të vitit paraardhës, por nuk është kryer për 6-mujorin paraardhës nga Sektori i Auditit të Brendshëm. Gjithashtu nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në këtë bashki.

2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.2.1. Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiare:

- Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre;
 - Inventarizimi periodik;
- 2.2.2. Auditim i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:**
- Llogarive të arkëtueshme;
 - Llogarive të pagueshme;
- 2.2.3. Auditim i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:**
- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat;
 - Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Tepelenë për vitin ushtrimor 2024 janë të nënshkruara nga z. T.P. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. S.K. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Tepelenë me shkresën nr. 277 prot., datë 11.02.2025, dhe konfirmuar nga DTH Tepelenë me shkresën nr. 54 prot., datë 11.02.2025, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Tepelenë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024**. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024:

Bashkia Tepelenë 2024, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Paga (600)	174,664	0.70	11
Sigurime Shoqërore (601)	25,046	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	112,581	0.70	7
Investime të brendshme (230-231)	220,966	2.00	41
Të tjera transferime korrente (606)	124,362	0.70	8
Total	657,619		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	13,152		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	13,152		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,315		
Nëntotali	11,837		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	10,653		
Bashkia Tepelenë 2024, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	0	0.70	0
Të ardhurat e veta	74,990	0.70	43
Total	74,990		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	1,500		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	1,500		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	150		
Nëntotali	1,350		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	1,215		

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b,

“Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.

Për vitin 2024, me Urdhrin nr. 178, datë 19.11.2024, të z. T.P. Kryetari i Bashkisë, me objekt “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme, inventarit të imët e materialeve”, është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve të institucionit i përbërë nga znj. M. N. kryerat i komisionit dhe anëtarët znj. K.S., z. D.A., znj. B.K., z. M.M., z. E.B., z. L.S.. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar Raporti për Inventarin Fizik pa numër protokollit dhe pa datë, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar Titullarit të Institucionit (Nëpunësit Autorizues).

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Tepelenë, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Lekë

Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	
Aktivet	2,973,999,699
Pasivet	223,378,044
Aktivet Neto	2,750,621,655

Lekë

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2024	258,940,646
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	24,870,072
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	30,723,408
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	203,347,166

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	24,870,072	19,652,145	5,217,927
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
	Totali	24,870,072	19,652,145	5,217,927

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 19,652,145 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 24,870,072 lekë. Kjo llogari kuadrone me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 4,839,194 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 20,030,878 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 49-50.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
31	Materiale	11,257,111	7,435,068	3,822,043
32	Inventar i imët	19,466,297	18,169,768	1,296,529
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		30,723,408	25,604,836	5,118,572

- Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 30,723,408 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 11,257,111 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 19,466,297 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 5,118,572 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 5,118,572 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndrshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 31 “Materiale”,** ka vlerën 11,257,111 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	7,435,068
Shtesa (K)	69,156,434
Pakësime (D)	65,334,391
Gjendja në 31.12.2024	11,257,111

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”,** ka vlerën 19,466,529 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2024	18,169,768
Shtesa (K)	1,296,529
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2024	19,466,297

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	1,254,774	1,254,774	0
431	Tatime e taksat	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0

465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë të ndryshëm	172,996,870	153,584,876	19,411,994
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	33,157,848	27,529,213	5,628,635
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	- 41,090,540	- 41,090,540	0
Totali		166,318,952	141,278,323	25,040,629
	Të tjera aktive afatshkurtra			0
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	37,028,214	33,874,193	3,154,021
Totali		37,028,214	33,874,193	3,154,021

- Gjendja e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,254,774 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,254,774 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 1.) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba”		Lekë
Çelje e vitit 2024		1,254,774
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		1,254,774

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 153,584,876 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 172,996,870 lekë me një rritje në vlerën 19,411,994 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2024		153,584,876
Shtesa (K)		26,086,168
Pakësime (D)		6,674,174
Gjendja debitore në 31.12.2024		172,996,870

Nr.	Emërtimi	Gjendje 31.12.2023	Sistemime (shtesa)	Shtuar gjatë vitit ushtrimor	Sistemime (pakësime)	Pakësuar gjatë viti ushtrimor	Gjendje 31.12.2024
1	Gjoba IVMT	2,290,000	0	0	0	0	2,290,000
2	KLSH	84,992,244	0	0	0	0	84,992,244
3	Legalizim	2,097,557	0	0	0	45,578	2,051,979
4	Zyra e tatimeve	22,233,765	0	4,387,775	0	2,551,922	24,069,618
	Biznesi i vogël	0	9,328,486	2,325,367	1,268,276	10,385,577	0
	Shpk	0	11,536,571	1,744,436	977,322	12,303,685	0
	Institucione	0	769,648	114,880	20,000	864,528	0
	Njësia Administrative Qendër	0	599,060	203,092	286,324	515,828	0
5	Ujësullësi Agjent Tatimor	16,443,652	0	2,471,186	46,494	0	18,868,344
6	Detyrime në pamundësi arkëtimi	24,718,646	0	0	0	0	24,718,646
7	Kontratrat	816,212	1585610	2,287,246	391,492	2,795,888	1,501,688
8	Detyrime taksë toke bujqësore	0	11604351	0	0	0	11,604,351
9	Detyrime tregtim leje karburanti	0	3750000	0	0	850,000	2,900,000
Totali		153,592,076	16,939,961	9,146,207	437,986	6,243,388	172,996,870

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

Me shkresën nr. 31/1 prot., datë 31.01.2025, z. G.G. Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave ka paraqitur pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar përmbledhësen mbi situatën debitore nga taksat dhe tarifat vendore më datë 31.12.2024, në vlerën 172,996,870 lekë, vlerë e cila është kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 49 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim” është kontabilizuar vlera - 41,090,540 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore të cilët nga Bashkia Tepelenë janë cilësuar si pa mundësi arkëtimi, ndërkohë që sipas trajtimit kontabël

kjo vlerë duhej të kontabilizohet në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Sipas informacionit kontabël llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar në vlerën 41,090,540 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

- Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 27,529,213 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 33,157,848 lekë me një rritje në vlerën 5,628,635 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)		Lekë
Çelje e vitit 2024		27,529,213
Shtesa (K)		33,157,848
Pakësime (D)		27,529,213
Gjendja debitore në 31.12.2024		33,157,848

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 12,549,167 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 928,469 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 3,610,071 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 498,845 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 52,599,510 lekë ku totali shkon në vlerën 70,186,062 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 33,157,848 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” është nënvlerësuar në vlerën 37,028,214 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1.

- Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 37,028,217 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohet në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 2.**) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”		Lekë
Çelje e vitit 2024		33,874,193
Shtesa (K)		15,571,296
Pakësime (D)		12,417,275
Gjendja kreditore në 31.12.2024		37,028,214

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Lekë		
		31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	II. Aktive Afatgjata	2,715,059,053	2,515,830,748	199,228,305
20	I. Aktive Afatgjata jo materiale	0	352,003	(352,003)
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	0	352,003	(352,003)

203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	2,507,419,781	2,336,319,642	171,100,139
210	Toka, Troje, Terene	302,847,617	300,575,585	2,272,032
211	Pyje, Plantacione	1,149,952,273	935,577,632	214,374,641
212	Ndërtesa e konstruksione	284,012,048	296,006,050	(11,994,002)
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	746,849,236	780,257,091	(33,407,855)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	6,695,331	6,028,917	666,414
215	Mjete transporti	4,574,937	5,173,571	(598,634)
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	12,488,339	12,700,796	(212,457)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0
	4. Investime	207,639,272	179,159,103	28,480,169
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	1,500,000	0	1,500,000
231	Për Aktive Afatgjata materiale	206,139,272	179,159,103	26,980,169

1. Aktivët Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 352,003 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përllogaritur amortizim vjetor në vlerën 352,003 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”		Lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		352,000
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2024		352,000
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		352,000
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		352,000
	5	Amortizim i akumuluar		352,000
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		0

Toka, troje, terrene (kosto historike)		Lekë			
Objekte inventari		Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Studim mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ilegale		352,003	0	0	352,003
Totali		352,003	0	0	352,003

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

2. Aktivët Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 300,575,585 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,272,032 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 302,847,617 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 3.**) në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”		Lekë
		Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		300,575,585
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2024		300,575,585
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		2,272,032
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		302,847,617
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		302,847,617

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 935,577,632 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 214,374,641 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,149,952,273 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	935,577,632
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2024	935,577,632
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	214,374,641
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,149,952,273
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	1,149,952,273

Lekë					
Pyje, kullota, plantacione (kosto historike)		Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Objekte inventari					
Pyje, kullota, plantacione		935,381,432	214,374,641	0	1,149,756,073
Pemë dekorative		196,200	0	0	196,200
Totali		935,577,632	214,374,641	0	1,149,952,273

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

- **Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 296,006,050 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,954,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 157,476,534 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 284,012,048 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 4.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	438,534,581
	2	Amortizim i akumuluar	142,528,531
	3	Gjendja në 01.01.2024	296,006,050
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	2,954,000
	5	Amortizim i shtesës	14,948,003
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	441,488,581
	5	Amortizim i akumuluar	157,476,534
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	284,012,048

- **Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 780,257,091 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka shtesa në vlerë 5,900,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 340,522,131 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 746,849,236 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 5.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,081,471,367
	2	Amortizim i akumuluar	301,214,276
	3	Gjendja në 01.01.2024	780,257,091
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	5,900,000
	5	Amortizim i shtesës	39,307,855
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,087,371,367
	5	Amortizim i akumuluar	340,522,131
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	746,849,236

- **Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 6,028,917 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,018,800 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 6,932,416 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 6,695,331 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 6.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		12,608,947
	2	Amortizim i akumuluar		6,580,030
	3	Gjendja në 01.01.2024		6,028,917
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		1,018,800
	5	Amortizim i shtesës		352,386
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		13,627,747
	5	Amortizim i akumuluar		6,932,416
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		6,695,331

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 5,173,571 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 545,100 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 18,575,852 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,574,937 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 7.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		22,605,689
	2	Amortizim i akumuluar		17,432,118
	3	Gjendja në 01.01.2024		5,173,571
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		545,100
	5	Amortizim i shtesës		1,143,734
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		23,150,789
	5	Amortizim i akumuluar		18,575,852
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		4,574,937

- **Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 12,700,796 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,909,628 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 28,911,755 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 12,488,339 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		38,490,466
	2	Amortizim i akumuluar		25,789,670
	3	Gjendja në 01.01.2024		12,700,796
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		2,909,628
	5	Amortizim i shtesës		3,122,085
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		41,400,094
	5	Amortizim i akumuluar		28,911,755
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		12,488,339

Lekë

Inventar ekonomik (kosto historike)		Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Objekte inventari					
Inventar ekonomik		31,990,466	2,909,628	0	34,900,094
Aredim i qendrave shëndetësore		6,500,000	0	0	6,500,000
Totali		38,490,466	2,909,628	0	41,400,094

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

Nga auditimi konstatohet se, asetet e kaluara nga Pushteti Qëndror pranë Bashkisë Tepelenë paraqiten sipas VKM-ve si më poshtë:

- Për **Bashkinë Tepelenë** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë, me VKM-në nr. 6, datë 06.01.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”, sipas lidhjes nr. 1, me 181 fletë, përfundon me numër rendor 1,367 dhe përmban **1,112 prona** të transferuara.

- Për **Komunën Qendër Tepelenë** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë me VKM-në nr. 843, datë 06.12.2021, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qendër, Qarku Gjirokastrë”. Lista e inventarit me 159 fletë përfundon me numrin rendor 1111 dhe përmban **577 prona**.

- Për **ish-Komunën Kurvelesh** është miratuar lista përfundimtare e pronave me VKM-në nr. 386, datë 25.05.2011, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Kurvelesh, Qarku Gjirokastrë. Lista e inventarit me 82 fletë përfundon me numrin rendor 554 dhe përmban **262 prona**.

- Për **ish-Komunën Lopëz** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë, me VKM-në nr. 380, datë 08.04.2009, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Lopëz të Qarkut të Gjirokastrës”, sipas lidhjes nr. 1, që përfundon me numër rendor 475 dhe përmban **357 prona**.

Nga auditimi konstatohet se referuar listave të miratuara të inventareve si më lart, Bashkia Tepelenë zotëron në **total 2308 asete**, nga të cilat për 1951 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Nga lista e aseteve të transferuara, konstatohet se Bashkia Tepelenë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me çertifikatë në ZVRPP Tepelenë vetëm asete të llojit troje, kullota, ara, etj., dhe nuk konstatohet të jenë kryer aplikime apo regjistrime për asetet e llojit objekte.

- Ndërkohë sa i takon aseteve të llojeve kullota/pyje transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, konstatohet se Bashkisë Tepelenë i janë transferuar asete sipas shtojcës nr. 28, me numër rendor 1-688 si vijon:

Gjithsej **29,340** ha, nga këto:

- Pyje **8,950** ha;
- Kullotë **19,989** ha;
- Toka joproductive **401** ha;

Nga auditimi konstatohet se, deri më datë 31.12.2023, nga 2308 asete në tërësi Bashkia Tepelenë ka regjistruar dhe pajisur me çertifikatë 214 asete me sipërfaqe 1,007 ha tokë të llojit pyje, kullota e ara, ose 7.2% të aseteve me vlerë kontabël të paraqitur edhe në bilanc prej 1,161,383,237 lekë. Ndërkohë që janë marra masa dhe është aplikuar për regjistrimin e 83 aseteve. Ndërsa për vitin 2024, në total janë pajisur me çertifikatë pronësie 8 asete, për të cilat të dhënat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja (m ²)	Adresa e pronësisë	Pronësi/përdorim	Data e çertifikimit
1	2/53	Tokë arë	3574	6,760	Majkosh	Në përdorim	28.05.2024
2	3/1	Tokë arë	3574	13,526	Majkosh	Në përdorim	28.05.2024

3	495/5	Kullotë	3661	52,693	Turan	Në pronësi	28.05.2024
4	495/6	Kullotë	3661	799,092	Turan	Në pronësi	28.05.2024
5	391/3	Kullotë	1529	3,576	Dragot	Në pronësi	21.06.2024
6	1556/3	Kullotë	3252	43,610	Salari	Në pronësi	23.07.2024
7	1556/4	Kullotë	3252	1,633,182	Salari	Në pronësi	23.07.2024
8	441	Kullotë	2405	50,674	Lekël	Në pronësi	21.11.2024

- Për aktivet që i përkasin llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Tepelenë të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 222 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Tepelenë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërmat “a-b”, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

- Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 457,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë me Nipt K29009502G është 510,086,359 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër me Nipt M23329601L. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Tepelenë është 457,000 ose 4.57% ($4.57 \cdot 10,000,000 / 100 = 457,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

5. Investimet

- Gjendja e llogarisë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,500,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,500,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata jo materiale”		Lekë
Gjendje në 01.01.2024		0
Shtesa (K)		1,500,000
Pakësime (D)		0
Gjendja në 31.12.2024		1,500,000

Për aktive afatgjata materiale	Lekë			
	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Hartim plane mbarshtrimi pyje kullota	0	1,500,000	0	1,500,000

Për aktive afatgjata materiale	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Totali	0	1,500,000	0	1,500,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

- Kjo llogari përbëhet nga një projekt me emërtimin “Hartim plane mbarshtrimi pyje kullota” në vlerën 1,500,000 lekë i përfunduar dhe i likuduar dhe për pasojë duhej të kontabilizohet në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, Klasa 23.

- Gjendja e **llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 179,159,103 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 26,980,169 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 206,139,272 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Gjendje në 01.01.2024	179,159,103
Shtesa (K)	26,980,169
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2024	206,139,272

Lekë

Për aktive afatgjata materiale	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Ndërtim ujësjellësi Nivicë - Peshtan				133,337,213
Rikonstrukcion ujësjellësi fshati Salari				13,798,059
FV matesa në kollone				254,000
Rikonstrukcion shkolla 9 vjeçare “A.Rustemi”				57,750,000
Rikonstrukcion Njësia Administrative Qendër				1,000,000
Totali	179,159,103			206,139,272

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 1,500,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 206,139,272 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 207,639,272 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, gërma “c”:

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Tepelenë më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	0	4,973,015	(4,973,015)
42	Detyrime ndaj personelit	12,549,167	12,398,209	150,958
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	928,469	1,736,624	(808,155)

432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	3,610,071	3,654,183	(44,112)
436	Sigurime shëndetësore	498,845	515,396	(16,551)
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	20,030,878	16,426,025	3,604,853
467	Kreditorë të ndryshëm	52,599,510	38,125,979	14,473,531
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	133,161,104	113,749,110	19,411,994
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		223,378,044	191,578,541	31,799,503

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** më datë 01.01.2024, është në vlerën 4,973,015 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Tepelenë. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 295,574,788 lekë dhe pakësime në vlerën 300,547,803 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”		Lekë
Çelje e vitit 2024		4,973,015
Shtesa (K)		295,574,788
Pakësime (D)		300,547,803
Gjendja debitore në 31.12.2024		0

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 12,549,167 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera	
Nr.	Datë		
1	06.01.2025	1,788,539	
2	06.01.2025	4,105,556	
3	06.01.2025	2,725,198	
4	06.01.2025	2,046,639	
5	06.01.2025	1,025,906	
6	06.01.2025	718,684	
34	13.01.2025	138,645	
Totali		12,549,167	

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 928,496 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera	
Nr.	Datë		
37	13.01.2025	823,469	
39	14.01.2025	105,000	
Totali		928,496	

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhet në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 3,610,071 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera	
Nr.	Datë		
35	13.01.2025	48,165	
36	13.01.2025	3,561,906	

Totali	3,610,071
---------------	------------------

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

- **Llogaria 436 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhet në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 498,845 lekë. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		Vlera	
Nr.	Datë		
36	13.01.2025		498,845
Totali			498,845

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Tepelenë në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 20,030,878 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masë 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”		Lekë
Çelje e vitit 2024		16,426,025
Shtesa (K)		10,721,379
Pakësime (D)		7,116,526
Gjendja debitore në 31.12.2024		20,030,878

Nr.	Objekti	Subjekti	Vlera	Ka kaluar afati Po/Jo
1	Hyrje e kalasë, vazhdimi pedonale	GPG Company	7,225	Po
2	Ujësjiellësi Progonat - Dhemblan	E. Contruksion	20,000	Po
3	Ndërtim Ujësjiellësi Salari	2T	1,693,613	Po
4	Ndërtim Ujësjiellësi Nivice - Peshtan	2T + GPG Company	10,872,566	Jo
5	Rikonstruksion fasada L. Demokracia	V.	311,200	Po
6	Rikonstruksion rrugë të brendshme në qytet	N. Shpk	235,000	Po
7	FV matëse në kollone	NG Structures	734,643	Jo
8	Rikonstruksion shkolla A. Rustemi	NG Structures	5,661,295	Jo
9	Blerje printera	F.	5,136	Po
10	Rikonstruksion Njësia Administrative Qendër	A. Contruksion	15,000	Jo
11	Rikonstruksion rruga “Bilbilente”	Sh.	225,000	Po
12	Rikonstruksion rruga e fshatit Mamaj	T-D	100,000	Po
13	Rikonstruksion rruga 15 Shtatori + Fshati Dragot	N. Shpk	60,000	Po
14	Rikonstruksion salla Këshilli Bashkiak	S.	55,200	Po
Totali			20,030,878	

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë.

- Për 10 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Tepelenë janë ngurtësuar fonde në vlerë 2,712,374 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Tepelenë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 2,712,374 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2024, janë në vlerën 38,125,979 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 52,599,510 lekë me një rritje në vlerën 14,473,531 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 8.) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2024		38,125,979
Shtesa (K)		171,649,107
Pakësime (D)		157,175,576
Gjendja kreditore në 31.12.2024		52,599,510

- **Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime) më datë 01.01.2024,** është në vlerën 113,749,110 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 26,093,368 lekë dhe pakësime në vlerën 6,681,374 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 133,161,104 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”		Lekë
Çelje e vitit 2023		113,749,110
Shtesa (K)		26,093,368
Pakësime (D)		6,681,374
Gjendja debitore në 31.12.2023		133,161,104

Lekë				
Operacione me shtetin (detyrime)	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Debitore te ndryshem	153,584,876	26,093,368	6,681,374	172,996,870
Persoerli,paradhenie,deficite,gjoba	1,254,774	0	0	1,254,774
Shuma te parashikuara per zhvleresim	-41,090,540	0	0	-41,090,540
Totali	113,749,110	26,093,368	6,681,374	133,161,104

- Nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Por si kundërparti në bilanc pasqyrohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 7.

Lekë			
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	2,750,621,655	2,544,661,704
D	FONDI I KONSOLIDUAR	2,750,621,655	2,544,661,704
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,745,782,461	2,541,435,584
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	4,839,194	3,226,120
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	2,973,999,699	2,736,240,245

Lekë			
Fondi i konoliduar	Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”		
2,750,621,655	Mbyllje më datë 31.12.2024		Çelje më datë 01.01.2024
	Debi		Kredi
		2,541,435,584	Çelja gjendja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” i datës 31.12.2023
	0	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	229,974,201
			Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.

	59,226,065	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	5,118,572	Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”
Totali	59,226,065		2,776,528,357	
			2,776,528,357 - 59,226,065 = 2,717,302,292	
			2,745,782,461 - 2,717,302,292 = 28,480,169	

Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,541,435,584 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 229,974,201 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 5,118,572 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 59,226,065 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 28,480,169 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 17.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 14,294,704 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 26,009,224 lekë ose me një rritje në vlerën 11,714,520 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	26,009,224	14,294,704
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	2,471,470	1,147,773
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	2,471,470	1,147,773
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	10,329,595	4,974,635
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	10,329,595	4,974,635
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	13,208,159	8,172,296
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	13,208,159	8,172,296
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksë kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 21,191,260 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 39,052,571 lekë ose me një rritje në

vlerën 17,861,311 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	39,052,571	21,191,260
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	8,999,832	7,020,223
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	8,999,832	7,020,223
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	11,669,184	9,116,814
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	9,035,734	6,566,910
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	2,014,310	1,896,122
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	4,000	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	4,000	224,264
7114	Të ardhura nga biletat	214,000	255,750
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	397,140	173,768
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	18,383,555	5,054,223

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 “Grante korente”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 351,664,105 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 378,939,894 lekë ose me një rritje në vlerën 27,275,789 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
72	V. GRANTE KORENTE	378,939,894	351,664,105
720	1. Grant korent i brendshëm	378,939,894	351,664,105
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	335,853,119	313,018,387
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	0	0
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficitit (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	9,828,927	9,686,505
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	33,157,848	27,529,213
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	100,000	1,430,000
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 157,532,525 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 173,846,313 lekë ose me një rritje në vlerën 16,313,788 lekë.

- **Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 16,212,267 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,985,602 lekë ose me një rritje në vlerën 8,773,335 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tepelenë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
6001	Paga, personel i përhershëm	166,553,313	151,456,900
6002	Paga personel i përkohshëm	7,293,000	6,075,625
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	22,215,742	14,299,220
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	2,769,860	1,913,047
	Totali	198,831,915	173,744,792

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 91,833,482 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 121,088,877 lekë ose me një rritje në vlerën 29,255,395 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tepelenë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME		
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	2,363,000	1,743,000
6021	Materiale dhe shërbime speciale	59,819,000	29,055,831
6022	Shërbime nga të tretë	37,634,707	27,378,000
6023	Shpenzime transporti	170,170	15,195,000
6024	Shpenzime udhëtimi	300,000	0
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	10,907,000	11,517,000
6026	Shpenzime për qiramarrje	300,000	193,000
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	2,000,000	1,250,000
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	7,595,000	5,501,651

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Tepelenë nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 8,631,884 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 115,728,391 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	V. TRANSFERIME KORENTE	124,360,275	125,334,745
604	1. Transferime korente të brendshme	8,631,884	6,146,527
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	0	0
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	8,631,884	6,146,527
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	115,728,391	119,188,218
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	115,728,391	119,188,218

Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 444,001,689 lekë dhe totali shpenzimeve është 439,162,495 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 4,839,194 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 4,839,194 lekë.

➤ Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve

të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➤ **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

➤ **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve:**

Nga Bashkia Tepelenë është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Programimi i PBA 2024-2026 dhe programimi i buxhetit vjetor 2024

Me Urdhrin nr. 2, datë 10.01.2023, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024- 2026.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 87 datë 30.11.2023, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokaster: me shkresën nr. 994/1 date 14.12.2023.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2024-2026 miratuar respektivisht me VKB nr.31 , datë 29/03/2023, me VKB nr. 80, datë 21/09/2023.

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2024-2026 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politikat e programit”; “Qëllimi Politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr.	shënime
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë	Programë	
2024-2026	599	1.03.2023	599	1.03.2023	miratim kalendari	31	29.03.2023	15	
	2	10.01.2023	599	1.03.2023	miratim tavaneve të shpenzimeve	31	29.03.2023	15	
					miratimi i tabelave të PBA	80	21.09.2023	15	

Burimi: Drejtoria e Financës

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2024-2026 me Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 31, datë 29.03.2023, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 31 datë 29.03.2023, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Tepelene për vitet 2024-2026”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 88 datë 30/11/2024, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokaster me shkresën nr. 994/1 date 14.12.2023.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2024 kanë vlerën 65,000,000 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 125,525,000 lekë, transferta specifike ka vlerën 108,614,000 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 299,139,000 .lekë dhe shpenzimet kanë vlerën 299,139,000 lekë. Gjatë vitit 2024, Bashkia Tepelene me VKB nr 39, datë 30..07.2024; VKB nr.68, date13.11.2024; VKB nr.73, date 02.12.2024; VKB nr.78,date 24.12.2024 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Janë alokuar fondet e trashëguara nga viti 2023, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 3,226,120 lekë;

Janë alokuar fonde shtesë transferte specifike për arsimin parashkollor nga ministria e linjes, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës minimale në vlerën 5,873,466 lekë;

Janë alokuar fonde për lilkujdimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 8,834,000 lekë

Janë alokuar fonde për përbalimin e krizës së rritjeve të cmimeve në vlerën 10,000,000 lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2023	Faza e I PBA 2024	Faza e II PBA 2024	Projekt Buxhet 2024
600	Paga	150,489,899	140,918,000	140,918,000	167,286,000
601	Sigurime Shoqërore	14,638,379	22,698,000	22,698,000	27,173,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	94,571,993	58,203,000	58,203,000	57,199,000
604.603	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,551,404	17,650,000	17,650,000	24,116,000
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	5,677,020	3,500,000	3,500,000	3,000,000
I	Shpenzime Korrente	268,928,695	242,969,000	242,969,000	278,774,000
230	Kapitale të Patrupëzuara				
231	Kapitale të Trupëzuara	4,124,720	28,920,000	28,920,000	20,365,000
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	4,124,720	28,920,000	28,920,000	20,365,000
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale	4,124,720	28,920,000	28,920,000	20,365,000
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
I+II +III	Totali I Shpenzimeve	273,053,415	271,889,000	271,889,000	299,139,000

Gjatë vitit 2024, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Tabela e ndryshimeve buxhetore

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Viti 2024	Nr. 88 datë 30.11.2023	299,139,000	Nr.39,dt. 30.07.2024	17,813,466	600+601,Paga dhe sigurime.	5,873,466	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera	11,940,000	602, ShP. operative	
					230+231 (Investime)	0	230+231 (Investime)	0
			Nr.68,dt. 13.11.2024	19,538,654	600+601,Paga dhe sigurime.	1,500,000	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera	18,038,654	602, ShP. operative	
					230+231 (Investime)	0	230+231 (Investime)	
			Nr.73,dt. 02.12.2024	10,000,000	600+601,Paga dhe sigurime.	5,600,000	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602, ShP. operative	4,400,000	602, ShP. operative	
					230+231, investime	0	230+231 (Investime)	
			Nr.78,dt. 24.12.2024	8,834,000	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602, ShP. operative	8,834,000	602, ShP. operative	
					230+231, investime	0	230+231 (Investime)	

			Buxheti shtesë	56,186,120	600+601,Paga dhe sigurime.	12,973,466	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602, ShP. operative	42,212,654	602, ShP. operative	0
					606	1,000,000	606	0

Burimi: Drejtoria e Financës, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave

Pasqyrë përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2024 sipas VKB përkatëse.

Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024 janë planifikuar të balancuara në vlerën 299,139 mijë lekë, sipas tabelës në vijim:

Tabela Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024

në mijë lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 88 datë 30.11.2023	Buxheti shtesë VKB nr.39 date 30.07.2024; VKB nr.68 date 13.11.2024; VKB nr.73 date 02.12.2024; VKB nr.78 date 24.12.2024 si dhe akt norm.XX dt XX.XX.XX; miratuar me urdher titullari dheakt normativ shperblim fundviti	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.88 datë 30.11.2023	Buxheti shtesë VKB nr.39 date 30.07.2024; VKB nr.68 date 13.11.2024; VKB nr.73 date 02.12.2024;VKB nr.78 date 24.12.2024 si dhe akt norm.XX dt XX.XX.XX; miratuar me urdher titullari dheakt normativ shperblim fundviti	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		1	2	1+2
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	63,000	30,253	93,253	Art. 600 Paga	167,286	8,450	175,736
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti I mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2022	2,000	1,226	3,226	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	27,173	-1,000	26,173
Total të ardhurat e veta	65,000	31,479	96479	Art.602 Shpenzime operative	57,199	61,919	119,118
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar				Art.604 Transferime korrente të brendshme	5,650	500	6,150
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	3,000	4,200	7,200
Transferta e pa kushtëzuar e	125,525	18,834	144,359	Art. 230-231 Investime	20,365	583	20,948

çelur për llogari të vitit 2024							
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2024				Fondi Rezervë + gjencës (609)	18,466	-18,466	0
Transferta e pakushtezuar specifike	108,614	5,873	114,487				
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit							
Totali i të ardhurave	299,139	56,186	355,325	Totali i shpenzimeve	299,139	56,186	355,325

Burimi: Drejtoria e Financës, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave

2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Tabela mbi treguesit buxhetor dhe burimin e financimit të shpenzimeve: në 000 lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Tepelene, për vitin 2024.											
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit		Nga Granti Qeveritar				% e mbulimit nga grantet
					Nga të ardhurat e veta	% e mbulimit nga të ardhurat e veta	Nga transfertat e pakushtezuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet	
1	Paga 600	175,736	172,454	98,1	20,391	11,82	74,278	77,785			88,18
2	Sigurime shoqërore 601	26,173	24,671	94,26	3,738	15,15	7,750	13,183			84,85
3	ShP. Operat 602+ 604 F. Rezervë	125,268	117,314	93,65	40,835	34,8	63,762	12717			65,2
4	Nd/Ekonom invalid 606	7,200	7,172	99,6	3972	55,38	3,200				44,62
5	Investime 230-231	20,948	16,134	77,01	6,245	38,7	9,889				61,3
	Totali	355,325	337,745	95,05	75,181	22,3	158879	103685			77,7

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit

Nr	Emërtimi i investimit	Nr dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh) vetem viti 2024	% e realizimit
1	Bashkefinansim,Rikons Shkolla A.Rustemi 15 %	Nr.88, date 30.11.2023	Granti pakushtezuar	3,215		
2	Blerje konteniere per mbetje urbane	Nr.88, date 30.11.2023	Granti pakushtezuar	1,200		
3	Rikonstruksion salla e Keshillit Bashkiak	Nr.88, date 30.11.2023	Granti pakushtezuar	1,200		
4	Rikonstruksion godina Njesia Administrative Qender	Nr.88, date 30.11.2023	Te ardhurat	3,000		
5	Mbikqyrje objekti shkolla 9 vjecare Avni Rustemi	Nr.88, date 30.11.2023	Te ardhurat	1,000		
6	Rikonstruksion elra e permiresim kullote	Nr.88, date 30.11.2023	Te ardhurat	1,500		
7	Hartim plan mbareshtimi pyje kullota (konsulence)	Nr.88, date 30.11.2023	Te ardhurat	1,500		
	Total të ardhurat e veta+grand pa kushtezuar			12,615		
1						
	Total Grant Kushtezuar					
1						
	Total nga te ardhura jashte limitit					

Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2024 nga të ardhurat e veta dhe granti

Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2024

Në 000/lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 31.12.2023	Shtesa detyrim i prapambetur gjate vitit 2024 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2024 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	Total Deturim i prapambetur 31.12.2024
4864100	Detyrime per vend. gjyqesore	122,999	0	0	122,999
4864200	D.P.per sherbime	10,339,850	6,192,421	3,631,627	12,900,644
4864300	D.P.per mirembajtje	3,317,713	9,422,972	762,000	11,978,685
4864400	D.P.per investime	5,528,329		1,820,100	3,708,229
4864400	D.P.per investime nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)				
4865600	D.P per mallra	14,565,302	4,628,233	10,875,878	8,317,657
4864900	D.P.te tjera	0			
	Totali	33,874,193	20,243,626	17,089,605	37,028,214

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Tabela e detyrimeve të prapambetura sipas formatit të raportuar në MFE për vitin 2024

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2023	Vlera e paguar gjatë vitit 2024 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3) (pakesime 2024)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2024 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2024) (shitesat 2024)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2024
1	2	3	4	5	6
4864100	Vendime Gjyqësore	122,999	0	122,999	122,999
4864200	Shërbime	10,339,850	3,631,627	6,708,223	12,900,644
4864300	Mirëmbajtje	3,317,713	762,000	2,555,713	11,978,685
4864400	Investime	5,528,329	1,820,100	3,708,229	3,708,229
4864600	Mallra	14,565,302	10,875,878	3,689,424	8,317,657
4864900	Të Tjera	0	0		
4864902	Shpronësime	0	0		
	Totali	33,874,193	17,089,605	16,784,588	37,028,214
Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrite e linjës)					
	Detyrime ne total				

Evidencat mbi realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore) për periudhën objekt auditimi, konfirmuar nga Dega e Thesarit në Rreth, pasqyra:

Në 000/lekë

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
a	b	7	8	9
I	Te ardhura nga Tatimet	495	194	
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	495	194	
II	Te ardhura nga Taksat	34,991	28,032	80,1
2	Taksa mbi B. Vogel			
3	Taksa e Pasurisë, ndertese	5,958	4,965	
4	Taksa mbi token Bujqesore	900	4,321	
5	Takse mbi rregj e Automjete	5,621	5,564	
6	Taksa e ndik te nd mbiinfrastrukture	20,000	10,306	
7	Takse Tabele	233	487	
8	Takse hoteli	12	69	
9	Takse Parkimi	250	444	
10	Takse per hapësira publike	429	729	
11	Takse reklame			
12	Takse kullote	595	1,010	
13	Takse shfrytezim lende drusore	993	138	
III	Te ardhura nga Tarifat	10,253	12002	117
12	Tarife Pastrimi	4,577	8,118	
13	Tarifë shërbim te tjera publike			
14	Tarife leje transport.	90	82	
15	Tarife vend banor/gj CIVILE			
16	Tarife urbanistike			
17	Tarife rregj biznes i Ri			
18	Tarife ndriçimi rrugor	3,406	3,066	
19	Te ardhura te tjera	2,000	671	
20	Tarife çertifikimi mishi	180	65	
IV	Te ardhura te tjera	50740	34763	68.5
21	Qera trualli	973	1621	
22	Shitje Pase&privatiz banese	2,500	4,205	
23	Qera kullote	5,630	6,934	

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
a	b	7	8	9
24	Tarifë uji i pijshëm			
25	Te ardhura te tjera	5377	16577	
26	Gjoha.	110	118	
27	Takse Vule			
28	Qera toke bujqesore	1,075	2,795	
29	Dhurata, sponsoi & Garanci.	0	100	
30	Te ardhura te tjera	34,475	1,562	
31	Te ardhura nga leje tregt karburanti	600	850	
	GJITHSEJ (I+II+III+ IV)	96,479	74,991	77,7

Niveli i detyrimeve të papaguara në fund të periudhave 2024, paraqitet si vijon, pasqyra:

Emërtimi	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2024 Kontabilizuar	
	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik	204	9,927,546	227	10,901,405	227	10,901,405
Nga subjektet juridik	49	11,536,751	60	12,303,685	60	12,303,685
Nga ambientet familjarë		16,397,158		18,868,344		18,868,344
Nga taksa e tokës bujqësore		10,149,164		11,604,351		11,604,351
Nga taksa infrast (ALUIZNI)		2,097,557		2,051,979		2,051,979
Nga institucione shtetore		769,648		864,528		864,528
Nga kontratat	27	2,010,330	37	1,501,688		1,501,688
Nga leje tregtim karburantesh		3,750,000		2,900,000		2,900,000
Nga kamat vonesa nëse ka						
Të tjera						
TOTALI		56,638,154		60,995,980		60,995,980

Bashkia Tepelenë miratoi buxhetin fillestar për vitin 2024 me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 88, datë 30.11.2023, në një vlerë totale prej 299,139,000 lekësh. Gjatë vitit, janë ndërmarrë katër ndryshime buxhetore përmes akteve shtesë:

- VKB nr. 39, datë 30.07.2024
- VKB nr. 68, datë 13.11.2024
- VKB nr. 73, datë 02.12.2024
- VKB nr. 78, datë 24.12.2024

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, buxheti përfundimtar për vitin 2024 arriti në **355,325,000 lekë**.

Të Ardhurat e Trashëguara dhe Rakordimi

Sipas Aktit të Rakordimit të fondeve të trashëguara, për vitin 2024 Bashkia Tepelenë ka trashëguar një total prej 3,226,120 lekësh, të shpërndara si më poshtë:

1. Kapitulli 01: 58,728 lekë
2. Kapitulli 05: 3,167,120 lekë

Këto fonde janë integruar në aktet buxhetore shtesë dhe janë alokuar për shpenzime sipas destinacioneve përkatëse, duke rritur kapacitetin buxhetor për vitin në fjalë.

Realizimi i Shpenzimeve

Nga një buxhet total prej 355,325,000 lekësh, shpenzimet e realizuara faktike për vitin 2024 arrijnë në 337,745,000 lekë, që përbën 95.05% të planit.

Detaje sipas natyrës së shpenzimeve:

Kategoria	Plani	Realizimi	% Realizim
Paga (600)	175,736,000	172,454,000	98.1%
Sigurime Shoqërore (601)	-	24,671,000	94.3%
Shpenzime Operative (602)	-	117,314,000	93.6%
Investime Kapitale (231)	20,948,000	16,134,000	77%

Performanca më e ulët u regjistrua në zërin e investimeve, ku u realizua vetëm 77% e planit, kryesisht për shkak të vonesave në procedurat e prokurimit publik dhe mungesës së kapaciteteve teknike për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit.

Të Ardhurat nga Burimet e Veta

Të ardhurat e planifikuara nga burimet e veta ishin 96,479,000 lekë, ndërsa realizimi faktik arriti në 74,991,000 lekë, që përbën një realizim prej 77.7%.

Taksat me realizim të ulët është Taksa për ndikimin në infrastrukturë: 51.5% dhe Taksa për shfrytëzimin e lëndës drusore: 13.9%

Tarifat me realizim mbi plan është Tarifa për pastrimin: 177% dhe Qiratë e kullotave: 123%

Ky devijim në realizim tregon nevojën për planifikim më realist dhe për përmirësim të mekanizmave të mbledhjes së të ardhurave.

Detyrimet e Prapambetura

Në fund të vitit 2024, detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tepelenë arritën vlerën prej 37,028,214 lekësh, nga të cilat janë shlyer 17,089,605 lekë gjatë vitit.

Struktura e detyrimeve:

- Për shërbime: 12,900,644 lekë
- Për mirëmbajtje: 11,978,685 lekë
- Për investime: 3,708,229 lekë
- Për mallra: 8,317,657 lekë
- Vendime gjyqësore: 122,999 lekë

Këto të dhëna nënvizojnë nevojën për një plan afatmesëm të likuidimit të detyrimeve dhe forcimin e kontrollit financiar në procesin e miratimit të shpenzimeve

Analiza e Investimeve

Gjatë vitit 2024, Bashkia planifikoi disa investime të reja të rëndësishme, të financuara nga të ardhurat e veta dhe granti i pakushtëzuar:

- Rikonstrukcioni i sallës së Këshillit Bashkiak
- Blerje kontenerësh për menaxhimin e mbetjeve
- Hartimi i një plani menaxhimi për kullotat
- Rikonstrukcioni i godinës së njësisë administrative

Nga një vlerë totale prej 12,615,000 lekësh, realizimi rezulton më pak se 80%, duke reflektuar vonesa në zbatimin e projekteve dhe sfida në menaxhimin e tyre teknik.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. T.P. Kryetar i Bashkisë Tepelenë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. S.K. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare.

2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 872/2 prot., datë 19.08.2024, ka raportuar pranë KLSH-së ecurinë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar kështu edhe afatin 20 ditor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 112 prot., datë 22.01.2025, ka raportuar pranë KLSH-së ecurinë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë administruar në KLSH me nr. 620/6 prot., datë 31.07.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 872/1 prot., datë 02.09.2024, janë rekomanduar gjithsej:

- 8** masa organizative;
- 3** masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë edhe detyrimet nga qiradhënie në vlerën **40,728,488 lekë**;
- 2** masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën **6,535,790 lekë**;
- 1** masë disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	8	8	0
Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	3 40,728,488	3	0
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash	2 6,535,790	2	0

Masa disiplinore	1	1	0
Totali	14	14	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Tepelenë:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	8	2	3	2	1
Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	3 40,728,488	0	0	3	0
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash	2 6,535,790	0	0	2	0
Masa disiplinore	1	0	0	1	0
Totali	14	2	3	8	1
Totali në %	100%	14.3%	21.4	57.1	7.2%

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 56/2 prot., datë 10.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë, është miratuar nga strategjia e riskut të institucionit me afat tre vjeçar. Me shkresën nr. 56 prot., datë 10.01.2023, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i përbërë nga 8 punonjës. Me shkresën nr. 56/1 prot., datë 10.01.2023, është miratuar Udhëzimi i Brendshëm për Vlerësimin e Monitorimit të Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masat për kryerjen e auditimit për zbatimin të rekomandimeve për 6-mujorin paraardhës të lëna nga NjAB. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 218 prot., datë 30.01.2024, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Tepelenë në të cilën Sektori i NjAB përbëhet nga dy pozicione pune konkretisht: 1 Përgjegjës Sektori dhe 1 Specialist Auditit.

Rekomandimi është i pa zbatuar

3.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë për vitin 2024 të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 33,874,193 lekë sipas metodës FIFO dhe duke aplikuar një balancë mes kufizimit të shpenzimeve dhe shlyerjes së detyrimeve, përkatësisht 5,528,329 lekë të investimeve nga Bashkia, 28.222.865 lekë nga mallrat dhe shërbimet, 122.999 lekë të vendimeve gjyqësore, duke marrë këto masa: reduktimin e shpenzimeve, rritjen e të ardhurave vendore, mbledhjen e arkëtimin e debitorëve, kërkimin e çeljes së fondeve nga qendra sipas burimit financimit të investimeve të kryera.

Brenda vitit 2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Detyrimet e prapambetura progresive më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 33,874,193 lekë nga të cilat është likuiduar vlera 16,369,618 lekë sipas Aktrakodimit me Degën e Thesarit Tepelenë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 31/1 prot., datë 31.01.2025, z. G. G. Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave ka paraqitur pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar përmbledhësen mbi situatën debitore nga taksat dhe tarifat vendore më datë 31.12.2024, në të cilën është përfshirë edhe vlera 2,785,790 lekë e kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Rekomandimi është zbatuar

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë të bëjë korrektime të duhura për llogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata jo materiale dhe të kryejë sistemimet e kontabël përkatëse në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

Deri me datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024, për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 352,003 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

6.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i zgjedhje i veprime të kryera me bankë u konstatua se, në dy raste evidentohet likuidime të faturave tatimore jashtë afatit 30 ditor konkretisht:

- Fatura tatimore nr. 29, datë 25.12.2023, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 791, datë 24.12.2024, në vlerën 325,000 lekë;

- Fatura tatimore nr. 388, datë 07.04.2021, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 792, datë 24.12.2024, në vlerën 327,000 lekë;

Rekomandimi në proces zbatimi

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 872/13 prot., datë 18.11.2024, me objekt “Për zbatim të detyrave të rekomanduara”, është caktuar Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, për ndjekjen e ecurisë dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Nga auditimi u

konstatua se, ky proces ka mbetur në fazën e daljes së këtij urdhri por nuk ka një relacion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për vlerësimin e kësaj situatë.

Rekomandimi në proces zbatimi

8.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masa Organizative

2.1. Rekomandimi: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse t’i jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Pjesërisht e zbatuar dhe ne proces

Në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë, të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve, referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Tepelenë.

E zbatuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit B. ShPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Tepelenë për 5 vjet, që nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike dhe të prapambetura të autorizimeve për të gjithë subjektet: B. Shpk në vlerën 100,000 lekë, O. Shpk në vlerën 380,000 lekë dhe S.G. Shpk në vlerën 800,000 lekë, me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

E zbatuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

E zbatuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1. Rekomandimi: Nga IVMT të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren për të konstatuar ndërtimet informale dhe ato që nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara, duke marrë vendime për prishje dhe duke i ekzekutuar ato, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Në proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet për punonjësit:

1. Z. L.B., me detyrë Drejtor i DPKZHT Tepelenë, nga periudha 01.11.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

2. Znj. J.K., me detyrë Nënkrjetare Bashkie/Drejtores e Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative (DLSHO), nga periudha 13.12.2004 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Vërejtje për punonjësit:

1. Z. S.K., me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016; 135.

2. Z. M.Sh., me pozicion Specialist Pyje Kullota Mbrojtje tokash, Ujitje Kullimit DZHR, nga periudha 10.07.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin

nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

3. Znj. B.Xh., me pozicion specialiste Mjedisi DZHT, nga periudha 17.04.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 1 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”.

4. Znj. Xh.P., me pozicion Specialiste Pyjesh, nga periudha 11.03.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

C.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masat Disiplinore” dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Vërejtje për punonjësit:

1. Z. G.Sh., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural (DZHR), nga periudha 06.04.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr.373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 136 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë

21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

2. Znj. Zh.M., me pozicion specialiste e jashtme, nga periudha 03.08.2020 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

3. Z. E.L., me pozicion Inspektor i IVMT Tepelenë, nga periudha 02.05.2018 e në vijim; për parregullsitë e konstatuara në 5 raste të zhvillimit të ndërtimeve në terren, të ndërtuara pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaratë për njoftim fillim punimesh pa u pajisur me certifikatë përdorimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014.

4. Z. K.N., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

5. Z. G.G. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe

6. Z. R.H. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, Për mangësitë e konstatuara: - Mosplanifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mos pasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhurave, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore - Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91,93,94 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB nr. 74, datë 28.12.2018, e ndryshuar, për paketën fiskale, duke krijuar gjatë vitit 2022 vlerë debitorë prej 1,733,167 lekë për taksat dhe tarifa vendore, duke mos realizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore në vlerën 20,381,313 lekë në fund të vitit 2022. - Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos marrje masash për arkëtim të taksës së ndërtesës e truallit dhe tarifave pastrim-ndriçim-gjelbërimit nga taksapaguesit të kategorisë “Familjar” dhe mos identifikimi i plotë i familjeve, që kanë detyrim për këto taksat e tarifa, pa llogaritur detyrimin e pa derdhur Bashkisë prej 16,397,158 lekë deri në fund të vitit 2022 për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, mangësi këto në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i 137 ndryshuar, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632,

datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117. - Për mosdisponim të dhënash të plota dhe të sakta për planifikimin e taksës bujqësore mbi baza reale, ku familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore, pasi Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore, që familjet zotërojnë në përdorim dhe me AMTP, mangësi këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1 dhe me VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar pika 4/4. - Për mos marrjen e masave për arkëtimin e vlerës debitorë progresive prej 2,078,937 lekë, të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet deri në fund të vitit 2022.

7. Z. H.Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Mbrojtjes së Tokës dhe Ujrave, për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, nga Bashkia Tepelenë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatim taksave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet që janë legalizuar me vlerë 2,097,558 lekë.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 177, datë 18.11.2024, me objekt “Për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet persona fizik/juridik që ushtrojnë veprimtarinë në Bashkinë Tepelenë”, është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. G.G., znj. B.K. dhe z. R.SH., për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet që ushtrojnë ekonomike në Bashkinë Tepelenë për periudhën nga data 15 nëntor deri më datën 20 Dhjetor 2024. Në zbatim të urdhrin të sipërcituar me shkresën nr. 20/12 prot., datë 20.12.2024, grupi i punës ka hartuar një Raport në të cilën janë evidentuar 84 subjekte janë njoftuar për detyrimet tatimore, 8 subjete ushtrojnë të pa u pajisur me Nipt. Gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar 1,345,075 lekë nga persona fizik dhe juridik. Gjatë kësaj periudhe u përgatitën 17 urdhra bllokimi për subjektet debitorë me status Shpk.

Rekomandimi në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e

detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive **22,233,772 lekë** e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave për 184 subjekte biznesi i vogël në shumën 599,060 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifave për 49 subjekte biznesi i madh në shumën 11,536,571 lekë;
- Detyrime nga 6 institucione në shumën 769,648 lekë;
- Detyrime nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në 3 raste në shumën 10,313,690 lekë;
- Detyrime nga NJ.A. Qendër në shumën 9,328,493 lekë.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 177, datë 18.11.2024, me objekt "Për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet persona fizik/juridik që ushtrojnë veprimtarinë në Bashkinë Tepelenë", është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. G.G., znj. B.K. dhe z. R.SH., për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet që ushtrojnë ekonomike në Bashkinë Tepelenë për periudhën nga data 15 nëntor deri më datën 20 Dhjetor 2024. Në zbatim të urdhrin të sipërcituar me shkresën nr. 20/12 prot., datë 20.12.2024, grupi i punës ka hartuar një Raport në të cilën janë evidentuar 84 subjekte janë njoftuar për detyrimet tatimore, 8 subjete ushtrojnë të pa u pajisur me Nipt. Gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar 1,345,075 lekë nga persona fizik dhe juridik. Gjatë kësaj periudhe u përgatitën 17 urdhra bllokimi për subjektet debitorë me status Shpk.

Rekomandimi në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe NJA, të marrë masa për krijimin e regjistrat të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë "familjare" me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Bashkia Tepelenë, bazuar në kontratën dypalëshe me agentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 16,397,158 lekë, në llogarinë përkatëse në degën e thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 177, datë 18.11.2024, me objekt "Për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet persona fizik/juridik që ushtrojnë veprimtarinë në Bashkinë Tepelenë", është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. G.G., znj. B.K. dhe z. R.SH., për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet që ushtrojnë ekonomike në Bashkinë Tepelenë për periudhën nga data 15 nëntor deri më datën 20 Dhjetor 2024. Në zbatim të urdhrin të sipërcituar me shkresën nr. 20/12

prot., datë 20.12.2024, grupi i punës ka hartuar një Raport në të cilën janë evidentuar 84 subjekte janë njoftuar për detyrimet tatimore, 8 subjete ushtrojnë të pa u pajisur me Nipt. Gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar 1,345,075 lekë nga persona fizik dhe juridik. Gjatë kësaj periudhe u përgatitën 17 urdhra bllokimi për subjektet debitore me status Shpk.

Rekomandimi në proces zbatimi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT TË ARDHURA TË MUNGUARA

1.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë Sektorit të Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorisë së Financës të marrin masa të kontabilizojnë detyrimin e krijuar nga Sha Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, si dhe bazuar në kontratën dypalëshe me agentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 2,785,790 lekë për vitin 2023, në llogarinë përkatëse në degën e thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 177, datë 18.11.2024, me objekt “Për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet persona fizik/juridik që ushtrojnë veprimtarinë në Bashkinë Tepelenë”, është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. G.G., znj. B.K. dhe z. R.SH., për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet që ushtrojnë ekonomike në Bashkinë Tepelenë për periudhën nga data 15 nëntor deri më datën 20 Dhjetor 2024. Në zbatim të urdhrin të sipërcituar me shkresën nr. 20/12 prot., datë 20.12.2024, grupi i punës ka hartuar një Raport në të cilën janë evidentuar 84 subjekte janë njoftuar për detyrimet tatimore, 8 subjete ushtrojnë të pa u pajisur me Nipt. Gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar 1,345,075 lekë nga persona fizik dhe juridik. Gjatë kësaj periudhe u përgatitën 17 urdhra bllokimi për subjektet debitore me status Shpk.

Rekomandimi në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Tatim Taksave të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Tepelenë me vlerë 3,750,000 lekë. Gjithashtu, Sektori i Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 177, datë 18.11.2024, me objekt “Për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet persona fizik/juridik që ushtrojnë veprimtarinë në Bashkinë Tepelenë”, është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. G.G., znj. B.K. dhe z. R.SH., për kryerjen e vizitës fiskale në të gjithë subjektet që ushtrojnë ekonomike në Bashkinë Tepelenë për periudhën nga data 15 nëntor deri më datën 20 Dhjetor 2024. Në zbatim të urdhrin të sipërcituar me shkresën nr. 20/12 prot., datë 20.12.2024, grupi i punës ka hartuar një Raport në të cilën janë evidentuar 84 subjekte janë njoftuar për detyrimet tatimore, 8 subjete ushtrojnë të pa u pajisur me Nipt. Gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar 1,345,075 lekë nga persona fizik dhe juridik. Gjatë kësaj periudhe u përgatitën 17 urdhra bllokimi për subjektet debitore me status Shpk.

Rekomandimi në proces zbatimi

E. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr.

152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 872/13 prot., datë 18.11.2024, me objekt “Për zbatim të detyrave të rekomanduara”, është caktuar Komisioni i Disiplinës së institucionit për ndjekjen e hapave për vlerësimin e shkeljeve të punonjësve të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Nga auditimi u konstatua se, ky proces ka mbetur në fazën e daljes së këtij urdhri por nuk ka një relacion nga Komisioni i Disiplinës për vlerësimin e kësaj situatë.

Rekomandimi është pa zbatuar

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. T.P. Kryetar i Bashkisë Tepelenë në cilësinë e titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për MFK-në u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

1. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezultoi se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet, por mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës të specialistit të IT.

2. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:

Është përcaktuar koordinatori i riskut me rregullore, por nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve e për pasojë dhe mungesës së veprimtarisë së tij, ka sjellë mos identifikimin e vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

3. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”:

- Bashkia Tepelenë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar akses të IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka mungesa në burime njerëzore. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk ekziston auditimi nga AB.

4. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”:

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njëjstëve të varësisë të saj.

5. Komponenti “Monitorimi”:

-Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-24 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 218 prot., datë 30.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative e Bashkisë Tepelenë, ku pjesë e saj është edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy pozicione pune konkretisht, një përgjegjës sektori dhe një specialist, pra struktura e NjAB nuk është e plotësuar e tre pozicione pune, në zbatim të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-24 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e strukturës së Njësive të Auditimit të Brendshëm duke përfshirë tre pozicione pune, duket përmbushur edhe njëkohësisht detyrimet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 49 “Shuma të parashikuar për zhvlerësim” është kontabilizuar vlera - 41,090,540 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore të cilët nga Bashkia Tepelenë janë cilësuar si pamundësi arkëtimi, ndërkohë që sipas trajtimit kontabël kjo vlerë duhej të kontabilizohej në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Sipas informacionit kontabël llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar në vlerën 41,090,540 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i

ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemin e vlerës 41,090,540 lekë nga llogaria 49 “Shuma të parashikuar për zhvlerësim” e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të klasifikimit të kësaj vlere debitore nga taksat dhe tarifatat vendore për zhvlerësim, duke e kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2026

4. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 12,549,167 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 928,469 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 3,610,071 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 498,845 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 52,599,510 lekë ku totali shkon në vlerën 70,186,062 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 33,157,848 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” është nënvlerësuar në vlerën 37,028,214 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 37,028,217 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhet të kontabilizohet në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të regjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Bashkia Tepelenë zotëron në total 2,308 asete të kaluara në pronësi me VKM-të përkatëse. Nga këto, Bashkia Tepelenë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me certifikatë në ZVRPP Tepelenë 214 asete me sipërfaqe 1,007 ha tokë të llojit pyje, kullota e ara, të cilat janë kontabilizuar në vlerën prej 1,161,383,237 lekë. Ndërkohë që janë marra masa dhe është aplikuar pranë DVASHK për regjistrimin e 83 aseteve të tjera. Nga auditimi konstatohet se veprimet e mësipërme janë kryer vetëm asete të llojit troje, kullota, ara, etj., dhe nuk konstatohet të jenë kryer aplikime apo regjistrime për asetet e llojit objekte. Gjithashtu konstatohet se për të gjitha asetet që i kanë kaluar në pronësi, Bashkia nuk ka kryer një inventarizim

periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre që pas kalimit në pronësi, nëse janë ende ekzistente apo të dëmtuara, të zaptuara rishtazi, privatizuara, etj. Po kështu sa i takon asetëve të llojeve kullota/pyje transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, konstatohet se Bashkisë Tepelenë i janë transferuar asete gjithsej 29,340 ha, nga të cilat 8,950 ha Pyje, 19,989 ha Kullotë dhe 401 ha Toka joproductive. Nga sipërfaqet e mësipërme rezulton se janë rregjistruar në ASHK Tepelenë rreth 29,000 ha.

- Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Tepelenë të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 222 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Tepelenë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërmat “a-b”, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për ngritjen e Strukturës së Menaxhimit të Pronave, për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia të transferuara me VKM, duke përcaktuar detyra konkrete dhe me përgjegjësi në Rregulloren e Brendshme të bashkisë për miradministrimin e pronave për verifikim fizik të tyre dhe ndjekjen e procedurave për regjistrim me asistencën e DVASHK-së Tepelenë. Gjithashtu Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të përditësojë regjistrin kontabël duke kryer të gjithë kontabilizimin e asteve të bashkisë me vlerën aktuale që ato kanë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 457,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë me Nipt K29009502G është 510,086,359 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër me Nipt M23329601L. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Tepelenë është 457,000 ose 4.57% ($4.57 \cdot 10,000,000 / 100 = 457,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitale e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2026

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,500,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,500,000 lekë. Kjo llogari përbëhet nga një projekt me emërtimin “Hartim plane mbarshtrimi pyje kullota” në vlerën 1,500,000 lekë i përfunduar dhe i likuduar dhe për pasojë duhej të kontabilizohet në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemin e vlerës 1,500,000 lekë nga llogaria 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të projektit për të cilin ka përfunduar procedura dhe likuiduar, duke e kontabilizuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

Deri më datë 31.03.2026

9. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 1,500,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 206,139,272 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 207,639,272 lekë e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, gërma “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Deri më datë 31.03.2026

10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Tepelenë në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 20,030,878 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 10 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Tepelenë janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,712,374 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Tepelenë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nuk janë marrë masa për zhblllokimin

e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 2,712,374 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në bashkëpunim Drejtorine e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrin masa për analizimin e përdorimit të fondeve që ju ka mbaruar periudha e garancisë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Brenda datë 31.12.2025

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” më datë 01.01.2024, është në vlerën 113,749,110 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 26,093,368 lekë dhe pakësime në vlerën 6,681,374 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 133,161,104 lekë. Nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Por si kundërparti në bilanc pasqyrohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 31.03.2026

12. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,541,435,584 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 229,974,201 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 5,118,572 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 59,226,065 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 28,480,169 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 31.03.2026

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë ka miratuar buxhetin fillestar për vitin 2024 me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 88, datë 30 nëntor 2023, me një vlerë totale prej 299,139,000 lekësh. Gjatë vitit, ky buxhet ka pësuar disa ndryshime përmes katër vendimeve të tjera të Këshillit Bashkiak, konkretisht më 30 korrik, 13 nëntor, 2 dhjetor dhe 24 dhjetor 2024. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, buxheti përfundimtar arriti në shumën totale prej 355,325,000 lekësh.

Sipas aktit të rakordimit të fondeve të trashëguara, Bashkia Tepelenë ka pasur një total prej 3,226,120 lekësh të trashëguara nga vitet e mëparshme, të shpërndara në kapituj të ndryshëm buxhetorë. Këto fonde janë përfshirë brenda ndryshimeve të miratuara gjatë vitit dhe janë alokuar për shpenzime në linjat respektive.

Në lidhje me realizimin e shpenzimeve për vitin 2024, nga një plan total prej 355,325,000 lekësh, janë realizuar faktikisht 337,745,000 lekë, që përbën 95.05 % të totalit të planifikuar. Realizimi për kategoritë si pagat dhe sigurimet shoqërore është përkatësisht me 98.1% dhe 94.3 %, si dhe për shpenzimet operative me një realizim prej 93.6%. Megjithatë, është shënuar një nënrealizim i theksuar në zërin e investimeve kapitale, me një realizim prej vetëm 77 % të planit. Kjo është ndikuar kryesisht nga vonesat në procedurat e prokurimit publik dhe kapacitetet e pamjaftueshme teknike për përgatitjen e dokumentacionit të tenderëve.

Sa i takon të ardhurave nga burimet e veta, planifikimi për vitin 2024 ka qenë në shumën prej 96,479,000 lekësh, ndërsa realizimi faktik ka rezultuar 74,991,000 lekë, ose 77.7% e planit. Në analizën e detajuar vërehet se disa taksa, si ajo për ndikimin në infrastrukturë dhe ajo për shfrytëzimin e lëndës drusore, kanë pasur një realizim të ulët, respektivisht 51.5 dhe 13.9%. Nga ana tjetër, disa tarifa si ajo për pastrimin dhe qiratë e kullotave kanë tejkaluar planin fillestar, duke arritur përkatësisht 177% dhe 123%. Këto devijime sugjerojnë nevojën për një planifikim më realist dhe për forcimin e mekanizmave të grumbullimit të të ardhurave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).

13.1. Rekomandim: Bashkia Tepelenë të marrë masat për planifikimin e të ardhurave nga burimet e veta, për të siguruar që planifikimi të jetë realist dhe në përputhje me tendencat aktuale të mbledhjes, duke shmangur mbivlerësimet që çojnë në devijime të theksuara. Forcimin e mekanizmave të mbledhjes së të ardhurave vendore, përmes rritjes së transparencës, ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe përdorimit të mënyrave të ndryshme të raportimit dhe ndjekjes si dhe rritjen e kontrollit financiar të brendshëm në fazat e miratimit dhe realizimit të shpenzimeve, për të siguruar që çdo angazhim buxhetor të jetë i mbështetur në burime reale dhe në përputhje me objektivat zhvillimore të bashkisë.

Menjherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2024 janë regjistruar në shumën totale prej 37,028,214 lekësh, nga të cilat gjatë vitit janë shlyer 17,089,605 lekë. Detyrimet Vlora me e lartë e detyrimeve shkon për shërbime, mirëmbajtje, investime, furnizim me mallra dhe në një masë më të vogël për vendime gjyqësore. Ky nivel i detyrimeve kërkon hartimin dhe

zbatimin e një plani afatmesëm për likuidimin e tyre, si dhe përmirësimin e kontrollit financiar në procesin e miratimit të shpenzimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: Bashkia Tepelenë të marrë masat për krijimin e një plani të qëndrueshme për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, duke u mbështetur në prioritizimin e pagesave sipas ndikimit në shërbimet publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në fushën e investimeve, Bashkia Tepelenë kishte parashikuar disa ndërhyrje të rëndësishme, si rikonstruksioni i sallës së Këshillit Bashkiak, blerja e kontenierëve për menaxhimin e mbetjeve, hartimi i një plani për menaxhimin e kullotave dhe rikonstruksioni i godinës së një njësie administrative. Megjithatë, nga vlera e planifikuar për këto investime, realizimi ka qenë më pak se 80%, duke reflektuar vonesa dhe probleme në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-45 të Raportit të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: Bashkia Tepelenë të marrë masat për përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe administrative, sidomos në drejtim të planifikimit dhe zbatimit të investimeve, për të shmangur vonesat në prokurime dhe për të garantuar realizim më të plotë të projekteve të miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë administruar në KLSH me nr. 620/6 prot., datë 31.07.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 872/1 prot., datë 02.09.2024, ku janë lënë për zbatim **8 masa** organizative, **3 masa** për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë edhe detyrimet nga qiradhënie në vlerën **40,728,488 lekë**, **2 masa** për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën **6,535,790 lekë** dhe **1 masë** disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 8 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 2 masa janë zbatuar plotësisht, 2 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 2 masë nuk janë zbatuar.

b. Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë edhe detyrimet nga qiradhënia janë rekomanduar 3 masa në vlerën 40,728,488 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë në proces zbatimi.

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash janë rekomanduar 2 masa në vlerën 6,535,790 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 2 masa janë në proces zbatimi.

d. Masa disiplinore është rekomanduar 1 masë e cila është pranuar plotësisht dhe është e pa zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-55 të Raportit të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tepelenë të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e rekomandimeve në proces zbatimi si më poshtë:

a. Për 3 masa organizative të zbatuar pjesërisht, 2 masa në proces zbatimi dhe 1 masë e pa zbatuar: nr. 1.1, 2.1, 3.1, 6.1, 7.1, dhe 8.1;

b. Për 3 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë edhe detyrimet nga qiradhënia në proces zbatimi: nr. 1.1, 2.1 dhe 3.1;

- c. Për 2 masa Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash në proces zbatimi: nr. 1.1, dhe 2.1;
- d. Për 1 masë disiplinore e pa zbatuar: nr. 1.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT